



Република Северна Македонија
Министерство за одбрана

RAPORT MBI SHKALLËN E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT 2021-2024 PËR PERIUDHËN 1 KORRIK - 31 DHJETOR 2022

Në përputhje me Politikën Aktive të Transparencës, Ministria e Mbrojtjes rregullisht dhe çdo gjashtë muaj përgatit dhe publikon një raport për shkallën e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Integritetit 2021-2024.

Raportet gjashtëmujore përgatiten në mënyrë të standardizuar, në një matricë të krijuar posaçërisht, e cila është pjesë e Planit.

Raporti i tretë për shkallën e zbatimit të Planit të Integritetit i referohet periudhës 01.07 - 31.12.2022.

Pas zbatimit të Planit të Integritetit 2021-2024, në vitin 2025 do të bëhet një rishikim i plotë i progresit të arritur nga zbatimi i Planit.

Organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit është Grupi i Punës për Ndërtimin e Integritetit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Për periudhën 01.07 - 31.12.2022, sipas Planit të Integritetit 2021-2024 dhe Planit të Veprimtarive për vitin 2022, janë planifikuar ose ndarë nëntë aktivitete sipas fushave: Burimet Njerëzore – dy aktivitete, Konflikti i Interesit – dy aktivitete, Misionet Ndërkombëtare dhe Operacionet – një aktivitet, Prokurimi Publik – dy aktivitete dhe Kontrolli i Brendshëm – dy aktivitete. Aktivitetet e realizuara janë realizuar me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS.

Shtatë aktivitete u realizuan plotësisht sipas planit, ndërsa dy aktivitete nga fusha e Misioneve dhe Operacioneve Ndërkombëtare (Aktiviteti 16 nga Matrica e Planit të Integritetit 2021-2024) dhe nga fusha e Prokurimit Publik (Aktiviteti 3.1.4 nga Plani i Aktiviteteve për vitin 2022), nuk janë realizuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022. Përkatësisht, CIDS ka autoritetin të punojë në aspektet "civile" të ndërtimit të integritetit në mbrojtje, dhe kështu për aktivitetet që synojnë drejtpërdrejt forcat e ushtrisë, do të duhet të marrë pëlqimin nga autoritetet kombëtare norvegjeze nëse kjo lloj mbështetje mund të të sigurohet.

Koordinator i Grupit punues për ndërtimin e integritetit

Vladimir Ançev

X. Fusha I: - Menaxhimi i burimeve njerëzore

Modeli: - Përmirësimi i efikasitetit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
1. Pasqyrë e sistemit për futjen e evidencës me shkrim për të gjithë procesin e punësimit dhe avansimit	Një analizë e punuar për të forcuar sistemin aktual të mbajtjes së të dhënave me shkrim për të gjithë procesin e punësimit dhe avansimit	Po	Përmirësimi i sistemit të marrjes dhe mbajtjes së evidencës me shkrim për të gjithë procesin e punësimit dhe avansimit	/	Aktiviteti 3 i Matricës së Planit të Integritetit 2021-2024 (aktiviteti 2.1.2 i Planit të Veprimit 2022) Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS
2. Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit të punonjësve të Departamentit të burimeve njerëzore për kryerjen e analizave të vendeve të punës.	Realizimi i trajnimit të analizës së vendeve të punës për punonjësit në Departamentin e burimeve njerëzore	Po Trajnimi i realizuar 19-20 Shtator 2022	Rritja e aftësive të punonjësve në Departamentin e burimeve njerëzore në drejtim të kryerjes së analizave të vendeve të punës në Ministrinë e Mbrojtjes.	11	Aktiviteti 2.1.3 i Planit të Veprimit 2022 Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS

Fusha II: - Konflikti i interesit

Modeli: - Mekanizma të përmirësuar për parandalimin e konfliktit të interesit

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
3. Hartimi dhe zbatimi i trajnimit "Ligjshmëria në vendimmarrje"	Realizimi i trajnimeve lidhur me ligjshmërinë në vendimmarrje	Po Trajnimi i realizuar në datat 6 - 7 qershor 2022	Trajnimi i projektuar dhe ofruar. Rritja e njohurive dhe përmirësimi i aftësive të stafit në fushën e ligjshmërisë në vendimmarrje.	22	Aktiviteti 1.1.6 i Planit të Veprimit 2022 Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS
4. Propozim për ngritjen e një sistemi në MM dhe Armatë për menaxhimin dhe monitorimin sistematik dhe të vazhdueshëm të konfliktit të interesave.	Një propozim i përgaditur për sistem të menaxhimit dhe monitorimit të konfliktit të interesave	Po	Forcimi dhe konsolidimi i sistemit ekzistues të monitorimit të konfliktit të interesit.	/	Aktiviteti 15 i Matricës së Planit të Integritetit 2021-2024 (aktiviteti 1.1.7 i Planit të Veprimit 2022) Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS

Fusha III: - Misionet dhe operacionet ndërkombëtare

Modeli: - Masa mbrojtëse të përmirësuara për të parandaluar korrupsionin në misionet dhe operacionet ndërkombëtare

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
<p>5. Krijimi i një sistemi për regjistrimin e mësimëve të nxjerra nga dislokimet e kaluara në misionet dhe operacionet ndërkombëtare nga perspektiva e rreziqeve të korrupsionit</p>	<p>Një procedurë e zhvilluar për regjistrimin e mësimëve të nxjerra nga vendosja në lidhje me rreziqet e korrupsionit.</p>	<p>Jo</p>	<p>/</p>	<p>/</p>	<p>Aktiviteti 17 i Matricës së Planit të Integritetit 2021-2024 (aktiviteti 1.1.8 i Planit të Veprimit 2022)</p> <p>Aktiviteti nuk është realizuar në periudhën e planifikuar (tremujori 4 i vitit 2022) për faktin se CIDS ka autoritetin të punojë në aspektet "civile" të mbrojtjes, dhe për rrjedhojë për aktivitetet që synojnë drejtpërdrejt forcat e Armatës, do të duhet të marrë pëlqimin nga autoritetet kombëtare norvegjeze nëse mundet për të ofruar këtë lloj mbështetje.</p> <p>Pas marrjes së pëlqimit, aktiviteti do të zbatohet.</p>

Modeli: - Struktura organizative e përmirësuar dhe kapaciteti institucional për të garantuar integritet dhe transparencë në prokurimet publike

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
6. Zhvillimi i një moduli dhe prezantimi i trajnimit për zhvillimin e specifikimeve teknike në proceset e prokurimit publik dhe atij të mbrojtjes	Realizimi i trajnimit për përgatitjen e specifikimeve teknike	Po Trajnimi i realizuar në datat 8-9 nëntor 2022	Rritja e njohurive dhe aftësive të përmirësuara të punonjësve për hartimin e specifikimeve teknike në proceset e prokurimit publik dhe të mbrojtjes.	19	Aktiviteti 21 i Matricës së Planit të Integritetit 2021-2024 (aktiviteti 3.1.3 i Planit të Veprimit 2022) Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS
7. Hartimi dhe zbatimi i Udhëzimeve për prokurimin në terren në misionet dhe operacionet ndërkombëtare	Udhëzimet e përgatitura për prokurimin në terren në misionet dhe operacionet ndërkombëtare	Jo	Zbatimi praktik i Udhëzimeve për prokurimin në terren në misionet dhe operacionet ndërkombëtare.	/	Aktiviteti 3.1.4 i Planit të Veprimit për vitin 2022 Aktiviteti nuk është realizuar në periudhën e planifikuar (tremujori 4 i vitit 2022) për faktin se CIDS ka autoritetin të punojë në aspektet "civile" të mbrojtjes, dhe për rrjedhojë për aktivitetet që synojnë drejtpërdrejt forcat e Armatës, do të duhet të marrë pëlqimin nga autoritetet kombëtare norvegjeze nëse mundet për të ofruar këtë lloj mbështetje.

Modeli: - Rritja e rolit të auditimit të brendshëm dhe inspektoratit në ndërtimin e integritetit

Aktiviteti	Rezultatet e pritura	Zbatimi i aktivitetit ("Po" dhe kur ato zbatohen në vazhdim, "Jo")	Rezultatet e arritura	Numri i njerëzve të përfshirë	Shënime shtesë
8. Hartimi dhe realizimi i trajnimit me temë "Qasja e lirë në informacion dhe mbrojtja e sinjalizuesve"	Realizimi i trajnimit lidhur me aksesin e lirë në informacion dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin e mbrojtjes	Po 25-26 tetor 2022	Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve në fushën e aksesit të lirë në informacion, si dhe të kuptuarit e praktikave më të mira në këtë fushë	21	Aktiviteti 1.1.5 i Planit të Veprimit 2022 Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS
9. Analizë e sistemit ekzistues të mbrojtjes së sinjalizuesve në MM dhe Armatë	Është bërë analiza e sistemit ekzistues të mbrojtjes së sinjalizuesve në MM dhe Armatë	Po	Rekomandime për përmirësimin e sistemit ekzistues dhe praktikave për mbrojtjen e sinjalizuesve brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës me qëllim zbatimin e tyre	/	Aktiviteti 34 i Matricës së Planit të Integritetit 2021-2024 (aktiviteti 1.1.9 i Planit të Veprimit 2022) Aktiviteti u realizua me mbështetjen e ekspertëve nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Norvegjisë - CIDS